

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.17. Dhjetor 2009.

Çmimi 50 lekë.

**BURIMI I UJIT
TEK "KODRA E
BUKUR" ËSHTË
PRONË E
STEBLEVËS DHE
I NEVOJITET
ASAJ**



**Nga Mersin Hoxha
Kryetar i Shoqatës**

Tanimë kemi të bëjmë me një konflikt të hapur, me një grabitje të poshtër, me një projekt abuziv dhe korruptiv. Është hapur një gjyq, fazën e parë të të cilit e ka fituar kryeplaku i fshatit Steblevë Rexhep Kurti dhe pa më të voglin dyshim që do të fitohet plotësisht në të gjitha shkallët sepse toka, kufijtë, burimet ujore, pyjet dhe kullotat nuk mund të tjetërsohen, ato egzistojnë objektivisht qysh me egzistencën e këtij populli në këtë zonë dhe nuk ka autoritet që t'i tjetërsojë apo t'ja kalojë dikujt tjetër pa lejen e komunitetit të Steblevës që u përkasin. Ky burim uji është pasuri natyrore që i përket territorit të Komunës së Steblevës dhe konkretisht fshatit Steblevë.

Burimi në fjalë është pjesë e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë-Guri i Shqipërisë dhe e këtij ekosistemi natyror sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 64 datë 21.05.2008.

(Vijon në faqen 2)

GJYKATA I JEP TË DREJTË STEBLEVËS PËR BURIMET E UJIT TEK "KODRA E BUKUR"

Vendimi i Qarkut të Dibrës për dhënie leje ndërtimi për ujësjellësin e livadhit të lepurit veç mangësive që ka nuk konsiderohet i ligjshëm përderisa i shtrin efektet jashtë territorit që ka në administrim.


Gjykata, bazuar në nenet 202/a dhe 204 vijues K.Pr.Civile
Vendosi

Pranimin e kërkesës që i përket kërkuarit Rexhep Kurti për "sigurimin e padisë".
Pezullimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësit rajonal Raduç-Ostren të kryera në territorin e fshatit Steblevë.

U shpall në Elbasan me datë 23.11.2009

Sekretare Klarita Biçoku

Gjyqtar Taulant Tafa



FALENDERIM

**Falenderojmë Av. Mehmet Kurtin,
për sponsorizimin e numrit 17 të gazetës "Stebleva"**

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI

*Kërkesë për
miratimin e listës
përfundimtare të
pronave,
që transferohen
në pronësi të
komunës Steblevë,
Librazhd*
FAQE 3

*Fisi Kormaku
në Steblevë*
FAQE 5

*Shqiptarët janë
autoktonë sepse
zbresin drejtpërdrejt
nga ilirët*

Nga Ramazan HOXHA
FAQE 7

*Copëza bisedash
Për bashkëfshat-
tarët e mi*

Nga Velo CFARKU
FAQE 8

Dibra lufton

Poezi nga Adelina Gruda
FAQE 4

ANGELS TRAVEL & TOURS
Mersin Hoxha
administratror

Biletë ajrore, Tregëti, Turizm, Akomodim

Adresa: Rruga e Baribadëve, P. 218, Kati përfaqësues
(Ngjarje me Librazhd "Mjell", Në bashkëpunim me tërësinë)
TIRANA - ALBANIA

Tel/Fax: +355 4 2222119 Cel: 069 20 65 091
e-mail: mersin_hoxha@yahoo.com / angels-tours@btinternet.com

B & A - 02 Sh.a.

bp & **FALCON** (Lubricants)

DRINA ONITARI I KRYEQITËS TIRANË

MEHMET D. KURTI
AVOKAT

Adresa:
Rr. "ALBAJIP" P. 28/4
Dyera-Redaktori Nr.80/4
e-mail: kurti_mil@hotmail.com

Tel/Fax: 042 354 177
Mobil: 068 20 54 888
068 20 17 783

BURIMI I UJIT TEK "KODRA E BUKUR" ËSHTË PRONË E STEBLEVËS DHE I NEVOJITET ASAJ

(Ekziston një projekt i përgatitur nga komuniteti ynë dhe i financuar prej tij)

(Vijon nga faqja 1)

**Nga Mersin Hoxha
Kryetar i Shoqatës**

Vetë fshati Steblevë ka 100 hektarë tokë të punueshme pa ujë dhe gjysma e fshatit është pa ujë të pijshëm.

Një pjesë e këtij uji është shfrytëzuar nga fshati Klenjë, Komuna Trebisht që në kohë të herëshme.

Shtojmë këtu faktin që egziston një projekt nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) në zbatim e sipër, projekt që mban datën 17.03.2009.

Nuk është për tu çuditur, por është për të vënë duart në kokë se si një fshat i largët disa kilometra i një komune jo fqin-

je kërkon ujë tek ne, ndërkohë që ka ujërat e veta sa për tu mbytur në Ostren të Vogël, apo në komunën fqinje, por vjen dhe grabit burimin tonë në fshatin Steblevë.

Problemi është i qartë, hapni hartën e fshatit Steblevë, të komunës Fushë-Studën, të rrethit Librazhd dhe të qarkut Elbasan dhe shikojeni se ku ka ndërhyrë komuna e Ostrenit e rrethit të Bulqizës e qarkut të Dibrës.

Leja jepet për burimin e ujit pranë postës kufitare të Gjinovcit, të Komunës së Trebishtit, nga Qarku i Dibrës, meqenëse Trebishti dhe Gjinovci nuk pranojnë, Komuna e Ostrenit futet dhe grabit ujin tonë tek vendi i quajtur "Kodra e Bukur".

Kërkojmë që të ndërpritet menjëherë ky projekt abuziv.

Prefektura e Qarkut të Elbasanit, Ministria e Punëve të Brëndshme, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ndërhyjnë menjëherë, të mos lejojnë vazhdimin e këtij projekti abuziv dhe kësaj grabitje të pashembullit.

Ky shtet nuk ka përse të lejojë që të harxhohen miliarda lekë për një ujësjellës, kur me këto para mund të ndërtohen disa ujësjellës. Megjithatë, thelbi i protestës sonë, i kërkesës sonë si komunitet është: "Mos prekni pronat tona, që i kemi mbrojtur me gjak në shekuj. Uji është jeta jonë. Nuk mund t'i ndërpresësh ujin e jetës një komuniteti për t'ja



dhënë një tjetri, aq më tepër kur është pronë e tij.

Ndaj këtij akti grabitqar komuniteti do të kundërshtojë

me të gjitha mjetet demokratike dhe në fund të fundit do ta mbrojë me të gjitha mënyrat pasurinë e tij.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT GJYQËSOR TË ELBASANIT PRANON KËRKESËN DHE I JEP TË DREJTË STEBLEVËS PËR ÇËSHTJEN E BURIMEVE TË UJIT TEK "KODRA E BUKUR"

(Avokati Mehmet Kurti mbron me sukses çështjen)

Vendimi i Qarkut të Dibrës për dhënie leje ndërtimi për ujësjellësin e livadhit të lepurit veç mangësive që ka nuk konsiderohet i ligjshëm përderisa i shtrin efektet jashtë territorit që ka në administrim.

Gjykata, bazuar në nenet 202/a dhe 204 vijues K.Pr.Civile Vendosi

Pranimin e kërkesës që i përket kërkuarit Rexhep Kurti për "sigurimin e padisë".

Pezullimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësit rajonal Raduç-Ostren të kryera në territorin e fshatit Steblevë.

U shpall në Elbasan me datë 23.11.2009

Sekretare Klarita Biçoku

Gjyqtar Taulant Tafa

Në numrin e kaluar të gazetës "STEBLEVA" jeni njohur me punën dhe përpjekjet e shoqatës "STEBLEVA" për mbrojtjen e burimeve të ujit, pyjeve, kullotave dhe pronave të komunitetit steblevas.

Meqenëse çështja e grabitjes së burimit të ujit tek Livadhi i lepurit tashmë po përbën një shqetësim të madh të mbarë komunitetit steblevas, u bë kallzimi penal në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Elbasanit.

Kryeplaku i fshatit Steblevë Rexhep Kurti paraqiti pranë Gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor të Elbasanit kërkesën për "sigurimin e padisë" ngritur kundër të paditurve zyra e urbanistikës KRRT Qarkut Dibrë, "Egland/B" sh.p.k dhe "Gjoka" sh.p.k, personit të tretë Komunës së Ostrenit të rrethit të Bulqizës, me objekt pushim cenimi dhe shpërbllim dëmi.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se subjektet ndërtuese "Egland/B" sh.p.k dhe "Gjoka" sh.p.k janë duke ndërtuar punime për ndërtimin e ujësjellësit Ostren-Raduç, punime këto të kryera sipas vendimit Nr 3 datë

26.06.2009 të KRT të këshillit të qarkut të Dibrës ku është miratuar leja e sheshit të ndërtimit.

Nga provat paraprake të ndodhura në dosje rezultoi se vendimi i lartpërmendur, konkretisht në lejen e ndërtimit nuk është përcaktuar subjekti ndërtues dhe licenca përkatëse duke shkelur në këtë mënyrë ligjin Nr 8405 datë 17.09.1998 "Për urbanistikën".

Po ashtu vetë Komuna Ostren me shkresën Nr 90 datë 27.08.2009 i ka kërkuar zyrtarisht Komunës Steblevë të konfirmojë dhe të miratojë marrjen e ujit të ujësjellësit që po ndërtohet nga burimi i quajtur me emërtimin popullor "Livadhi i lepurit" dhe kjo e fundit nuk ka miratuar këtë kërkesë, pasqyruar edhe në vërtetimin e Komunës Trebisht datë 29.09.2009. Sipas dokumentave të vitit 1937, e rifreskuar në vitin 2001 janë përcaktuar kufijtë midis fshatrave Steblevë, Klenjë, Gjinovci, Trebisht dhe Borovë ku kryepiqet e këtyre fshatrave kanë rënë dakord me përcaktimin e kufijve.

Pra në rastin konkret sipas dokumentit të lartpërmendur si

dhe hartës përkatëse të fshatit Steblevë, miratuar kjo edhe nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën Nr 3877/1 prot datë 10/09/2007 rezultoi se fshati Klenjë nuk ka kufitar fshatin Ostren dhe se vendi i quajtur me emërtimin popullor "Kodra e Bukur" përfshihet në territorin e fshatit Steblevë, që si njësi administrative, bazuar edhe në ndarjen territoriale administrative përfshihet si territor i Qarkut të Elbasanit, pra edhe vendimi i Qarkut të Dibrës për dhënie leje ndërtimi për ujësjellësin e lartpërmendur veç mangësive të cituara më lart nuk konsiderohet i ligjshëm përderisa i shtrin efektet jashtë territorit që ka në administrim.

Veç sa më lart në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 64 datë 21.05.2008 zona pyjore fshati Steblevë është shpallur "Park Kombëtar" e mbi këtë bazë Këshilli i Komunës Steblevë me vendimin Nr 62 datë 06.09.2007 ka vendosur të miratojë planin e menaxhimit të projektit të pyjeve dhe kullotave, e miratuar kjo nga Prefekti i Qarkut të Elbasanit sipas konfirmimit të aktit datë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN
NR.REGJ.THEM 32(91000-03178-13)
NR. VENDIMI 32 (13-2009-8138)

V E N D I M
" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e Shkalles se Pare , e rrethit Gjyqësor Elbasan, me trup gjykues te perbere nga :

Gjyqtar- TAULANT Tafa

Ne prani te sekretares Klarita Bicoku, mori ne shqyrtim ne seance gjyqësore , ne dt 23.11.2009, ceshtjen civile nr 32 akti, qe i perket :

KERKUES : Rexhep Kurti perfaqesuar me autorizim nr 4 dt 15.10.2009 nga Av. Mehmet Kurti Dhoma e Avokatise Tirane .

OBJEKTI : Sigurim padie.

BAZA LIGJORE : Neni 202 vijues K.Pr .Civile.

Gjykata , pasi e shqyrtoi ceshtjen ne teresi

PER KETO ARSYE

Gjykata , bazuar ne nenet 202/a dhe 204 vijues K.PR.Civile

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses qe I perket kerkuesit Rexhep Kurti per " Sigurimin e padise "

Pezullimin e punimeve te ndertimit te Ujesellesit Rajonal Raduç - Ostren te kryera ne territorin e fshatit Stebleve.

Kerkuesit I jepet afat 15 dite nga dita e sotme te paraqese padine ne gjykate .

Kunder vendimi lejohet ankim I vecante.

10.09.2007 ku janë bashkëngjitur dhe harta territoriale e Komunës së Steblevës.

Para fakteve të tilla gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuari përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara në nenin 202/a të Kodit të Procedurës Civile, e si e tillë duhet pranuar.

Gjykata çon që dokumentat e disponuara në dosjen gjyqësore justifikojnë kërkesën e paraqitur nga kërkuari Rexhep Kurti, për "sigurimin e padisë".

Për këto arsye Gjykata, bazuar në nenet 202/a dhe 204 vijues K.Pr.Civile Vendosi

Pranimin e kërkesës që i përket kërkuarit Rexhep Kurti për "sigurimin e padisë".

Pezullimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësit rajonal Raduç-Ostren të kryera në territorin e fshatit Steblevë.


U shpall në Elbasan me datë 23.11.2009

**Sekretare Klarita Biçoku
Gjyqtar Taulant Tafa**

KOMUNA E STEBLEVËS I KËRKON INSPEKTORIATIN TË NDËRTIMIT TË QARKUT TË EL-BASANIT PRISHJEN E PUNIMEVE TË DERITANISHME DHE MOSVAZH-DIMIN E PUNIMEVE.

Këshilli i Komunës së Steblevës në mbledhjen e tij të datës 17.11.2009 pasi u njoh me procedurat e deritanishme në lidhje me ndërtimin pa leje në territorin e komunës sonë të ujësjellësit të Komunës së Ostrenit kërkon nga inspektoriatin i ndërtimit të Qarkut të Elbasanit prishjen e menjëhershme të këtij objekti për të shmangur konfliktet sociale midis fshatrave dhe komunave.

KOMUNA E TREBISHTIT NUK I KA DHËNË LEJE KOMUNËS SË OSTRENIT PËR TË MARRË UJË BRENDA KUFIJVE TË SAJ



Me anë të vërtetimit të datës 29 shtator 2009, kryetari i komunës së Trebishtit Fitim Balla vërtetoi se Këshilli i Komunës së Trebishtit nuk ka miratuar kërkesën e Komunës së Ostrenit për të marrë ujë brenda kufijve të komunës

së Trebishtit.

Më poshtë po japim faksimiljen e këtij vërtetimi të lëshuar sipas kërkesës së Komunës së Steblevës dhe të shoqatës "STEBLEVA".

KRYETARI I KOMUNËS SË OSTRENIT, RAZI RAMA PRETENDON SE KA MBËSHTETJE POLITIKE PËR PROJEKTIN E TIJ TË PALIGJSHËM

Shoqata "STEBLEVA" dhe kryesia e saj kanë informuar të gjitha strukturat e shtetit dhe kanë sensibilizuar mediat për shkeljet dhe abuzimet e kryetarit të Komunës Ostreni Razi Rama, për projektin e paligjshëm dhe abuziv të ujësjellësit Raduç-Ostreni.

Gjykata e e shkallës së parë të Elbasanit pranoi padinë e kryeplakut të Steblevës Rexhep Kurti duke vënë re se janë shkelur tre ligje, ligji "për pushtetin lokal", ligji për urbanistikën dhe ligji "për mjedisin".

Ndërsa kryetari i komunës së Ostrenit Razi Rama, që ligjërisht e kupton se e ka humbur davanë kalon në përgojime të pashëmbullta duke pretenduar se ka paguar në qarkun dhe në prefekturën e Elbasanit që ata të mos hapin gojën, se ka mbështetje politike, se unë jam kryetar i votuar tre herë nga populli dhe nga subjekti i Partisë Demokratike.

Zoti Rama në korrupsionin ku je zhytur të paktën mos merr edhe njerëz të tjerë me vehte se s'ta kanë për borxh. Ne jemi shtet ligjor dhe do të triumfojë shteti ligjor. Përgatitu të përballesh me ligjin dhe me realitetin e krijuar që do të thotë përgatitu të përballesh me popullin e Steblevës, të cilin e ke grabitur.

KËRKESE PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, (PYJEVE DHE KULLOTAVE) QË DUHET TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS STEBLEVË, LIBRAZHDI

Drejtuar: Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
Z. Fatmir Mediu
Ministrit të Brendshëm
Z. Lulzim Basha
Prefektit të Qarkut të Elbasanit

Komuna e Steblevës shtrihet në rrethin e Librazhdit dhe zotëron një sipërfaqe të përgjithshme prej 9945 hektarësh ku përfshihen toka bujqësore, troje, pyje, kullota dhe livadhe, nga këto 2418 ha pyje, dhe 4010 ha kullota dhe livadhe. Jemi e vetmja komunë në rrethin tonë që ende deri më sot nuk i kemi marrë në pronësi këto pasuri nga ana e Qeverisë, pasi kemi pasur disa mospërputhje me ndarjen dhe përfshirjen e të gjitha pasurive që ka patur dhe duhet të ketë kjo komunë.

Në vitin 2000 jemi përfshirë në Projektin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me financim të Bankës Botërore, projekt që është rishikuar në vitin 2007. Ky projekt është miratuar nga këshilli i komunës dhe nga Prefekti i Elbasanit. Tradita jonë ka qenë dhe është: "Pyjet na japin jetë". Në kuadrin e këtij projekti kemi realizuar punimet e mëposhtme:

- " Përmirësime pyjesh 227 ha
- " Prita malore 495 metra kub
- " Ndërtime dhe meremetime lerash uji 6 copë
- " Ndërtime koritash uji me beton 30 ml.

Puna vazhdon. Rrallë mund të shihen pyje qaq të mbrojtur siç janë pyjet e Steblevës.

Fshati i Steblevës zotëron tapinë e vitit 1937, tapi të cilën e ka ripërtërirë në vitin 2002 me të gjithë fshatrat fqinje.

Meqenëse kohët e fundit kemi patur dëmtime dhe shfrytëzime pa kriter në pyllin e "Përroit të Govatave", pjesë e territorit të Steblevës dhe ndonëse Drejtoria e Shërbimit Pyjor Bulqizë e ka të qartë këtë ndarje, megjithatë bën rolin e të paditurit sepse dikujt i intereson të grabisë pyjet tona, kërkojmë prej jush:

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neneve 2, 3 dhe 17 të ligjit Nr 8744 datë 22/02/2001 "Për transferimin e pronave të palujtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit Nr 9385 datë 04/05/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, ju dërgojmë propozimin për në Këshillin e Ministrave të listës përfundimtare të pronave të palujtshme publike (pyjet dhe kullotat) e Komunës Steblevë me vërejtjet tona duke u përfshirë edhe 16 ngastrat pyjore nga numri 39 deri në numrin 55 të ekonomisë pyjore Klenjë-2 (Mikrobazenin e Përroit të Govatave). Me autoritetin tuaj, bazuar në të dhënat e drejtorive të shërbimit pyjor Bulqizë dhe Librazhd kemi besim se do të përpilohen këto të dhëna në afatin më optimal dhe do të regjistrohen si pronë e komunës Steblevë, që ne si edhe deri më sot të vazhdojmë të punojmë për ruajtjen dhe administrimin sa më të mirë të tyre.

KRYETARI I KOMUNËS XHEVIT BORIÇI

TAKIM ME DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË POLITIKAVE PYJORE NEHAT ÇOLLAKU

Pas shkresave të dërguara ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave Z. Fatmir Mediu, Ministrit të Brendshëm Z. Lulzim Basha si dhe Prefektit të Qarkut të Elbasanit për kalimin e 16 ngastrave pyjore nga numri 39 deri në numrin 55 të ekonomisë pyjore Klenjë-2 (Mikrobazeni të Përroit të Govatave) në administrim të Komunës së Steblevës siç është në fakt me tapi dhe të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të Librazhdit, Kryesia e Shoqatës "Stebleva" e përbërë nga Mersin Hoxha, kryetar i saj, Arif Tamizi, sekretar dhe Trifon Vfaruku inxhinjer pyjesh, me datë 8 dhjetor 2009, bëri një takim me drejtorin e përgjithshëm të politikave pyjore z. Nehat Çollaku.



Z. Nehat u njoh me dokumentacionin që ka fshati i Steblevës që zotëron tapinë e vitit 1937, tapi të cilën e ka ripërtërirë në vitin 2002 me të gjithë fshatrat fqinje.

Ai u zotua se do ta ndjekë këtë problem deri në kalimin e plotë të këtyre par-

celave nga juridiksioni i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Bulqizë në juridiksionin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor të Librazhdit.

Arif Tamizi

FALENDERIM

Kryesia e Shoqatës "Stebleva" falenderon të gjithë ata që mbështetën shoqatën "Stebleva" në veprimtarinë e saj për mbrojtjen e pasurive pyjore dhe ujore duke kontribuar edhe financiarisht.	20.	Emrulla Hoxha	1000 lek
Kontribuan financiarisht:	21.	Ali Bushati	1000 lek
1. Abib e Sabrian Kormaku 9500 lek (të reja)	22.	Agim Nura	1000 lek
2. Trifon Cfaruku 5000 lek	23.	Vahit Kormaku	1000 lek
3. Ferit Pirushi 5000 lek	24.	Altin Gruda	1000 lek
4. Pëllumb Uliu 2000 lek	25.	Kadri Bushati	1000 lek
5. Gjetan Nura 1500 lek	26.	Astrit Bushati	1000 lek
6. Isuf Murati 1000 lek	27.	Sabedin Lula	1000 lek
7. Qamil Lila 1000 lek	28.	Rexhep Avda	1000 lek
8. Xhemal Disha 1000 lek	29.	Izmir Hoxha	1000 lek
9. Ismail Hoxha 1000 lek	30.	Bert Uliu	1000 lek
10. Mehmet Hasani 1000 lek	31.	Jonuz Hoxha	1000 lek
11. Rruzhdin Kormaku 1000 lek	32.	Faik Rade	1000 lek
12. Sabri Uliu 1000 lek	33.	Arianit Nura	1000 lek
13. Sulejman Agushi 1000 lek	34.	Maksut Hoxha	1000 lek
14. Halil Kurti 1000 lek	35.	Bashkim Hoxha	1000 lek
15. Sefedin Avda 1000 lek	36.	Jetmir Gruda	1000 lek
16. Faik Kormaku 1000 lek	37.	Ramadan Tamizi	1000 lek
17. Sali Çausi 1000 lek			
18. Iqmet Çausi 1000 lek			
19. Emrian Gjini 1000 lek			

KRYESIA E SHOQATËS "STEBLEVA"

MIRËNJOHJE PËR TË GJITHË ATA QË KONTRIBUAN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË SË RE

Xhamia e Steblevës u ringrit edhe më e bukur falë kontributit madhor të komunitetit të Steblevës.

Një mbështetje të madhe dha kryesia e shoqatës "Stebleva" dhe kryetari i saj Mersin Hoxha, Komuniteti Mysliman (Medreseja) si dhe grupi nismëtar i kryesuar nga Arianit Nura.

Një kontribut të çmuar kanë dhënë Ferhat Lila (Ferhati), Fatjon Disha, Hajredin Kurti, Medi Cani, Shaban Kurti, Artan Caushi, Sali Xhebrahimi (tregëtar nga Sauku i Tiranës), Halil Fejza, Gëzim Shahu, Ferdinand Bakalli, Ferit Piku si dhe të gjithë ustalarët që u punuan pa u lodhur.

Për ndërtimin e xhamisë u mblodhën 2509100 lekë të reja nga Eduart Ferhati, Arben Hoxha, Klod Kondi, Altin Hoxha, Klodian Caushi, Arberin Hoxha, Durim Rade, Izmir Hoxha, Fadil Hoxha, Imer Bushati, Ardian Hoxha, Bashkim Hoxha, Gjetan Nura, Jonuz Hoxha, Maksut Hoxha, Asjap Gruda, Besnik Nura, Faik Kormaku, Artur Koçi, Baki Rade, Emrulla Hoxha, Flamur Muça. Caush Zeneli, Indrit Shqarthy, Altin Gruda, Zaim Kita, Avdyll Hoxha, Emsian Gjini, Zylyf Avda, Sokrat Zorba, Fatmir H. Kormaku, Sulejman Agushi, Ferit Bushati, Agron Ferhati, Ferit Pirushi, Spartak Gruda, Murat Basha, Vait Kormaku, Klesti Kurti, Ali Bushati, Rruzhdin Kormaku, Besnik Avda, Xhevdet Abazi, Medi Kurti, Rexhep Kuburi, Sabrian Kormaku, Iljaz Tamizi, Gani Gjini, Xhemail Biçaku, Enver Gruda, Elez Ferhati, Naim Shapku, Nazmi Berberi, Xheladin Ferhati, Irfan Uliu, Shkëlqim Gruda, Hamdi Kurti, Agim Gjini, Sali Caushi, Rexhep Bushati, Arif Hoxha, Flamur Hoxha, Kimet Daku, Mersin Hoxha dhe Arianit Nura.

Zoti ua shpërbleftë ! Zoti i bekoftë !

NGA KOMUNITETI I STEBLEVËS



STEBLEVA DHE FSHATRA FQINJE SIPAS REGJISTRIT TURK TË VITIT 1467

EMËRTIMI I FSHATIT: STABLEVË

Taksidar: Ali Uzguri (Skura)

Banorë, kryefamiljarë:

Kojo Porteviri, Petro Gjonko (Gjoneko), Martin Petro Gjonko, Miho Pishtaj, Gjon Mahinovi, Bogiç Mahinovi, Vasil Nikolla, Bogdo Jerakari, Kolë Vlladini, Stanec Vlladini, Simko Çermenika, Vaskë Gjoneko.

Shtëpi: 13

Prodhim: grurë, thekër, tërshërë dhe egjër, mjaltë, etj.

Të ardhura: 776 lira turke, flori

FSHATRA FQINJE

KLENJA

Emërtimi: Kilan

Taksidar: Haxhi Hamzai

Banorë:

Dhimitër Sysjapi (Sysjapi), Gjurçe Sysjapi, Miho Tishani.

Shtëpi: 3

Të ardhura: 198 lira

ZABZUNI:

Taksidar: Haxhi Hamzai

Banorë;

Vasili i Mihos, Bogiçi i Mihos, Gjorgoja i Dabçes.

Shtëpi: 3

Të ardhura: 148 lira

BOROVA

Taksidar: Ali Uzguri

Banorë; Gjergj Vrapci, Pop Stanisha, Peter Cankeri, Jerosllav Pjeri, Stojko Pjeri, Stojko Drashkeviçi, Radec Çermenika, Mihal Çermenika, Petko Çermenika, Pavel Çermenika, Lekë Dragoi, etj

Shtëpi: 27

Të ardhura 1747 lira

TREBISHTI:

Taksidar: Haxhi Muhameti

Shtëpi: 30

Të ardhura: 2418 lira

TRADITË PATRIOTIKE DHE LUFTARAKE

DIBRA LUFTON

(Shtator 1913)

*Lufton Dani, Prenga, Ademi**

Për Shqipninë jetën e kemi

Nga e gjithë Lura ujen urdia

Në Viçisht u mblodh ushtria

Katolikë e myslimanë

Të bashkuar për vatanë

Dani e Prenga dhanë

kushtrimin

Prini trima për shqiptari

Flet Ademi nga Stebleva

Latif Musta nga Borova

Vjen Toptani me luftue

Vjen Zogolli me e ndihmue

Flakë merr Struga dhe

Gostivari

Ndër trimat Xhema i pari

Luftojnë Camajt për Shqipni

Bini burra shkjaout të zi

Ky Nezir e Zeqir Bojaxhi'

Dhanë jetën për liri

Për flamur dhe për atdhe

Edhe Camajt janë me ne.

Nga Stebleva në Viçisht

Që nga Lura në Selishtë

Luftojnë trimat dibranë

Nuk dihet se sa janë

Ndalu serb, ktu asht Shqipni

Asnji krajl s'ka mund me hy

Selam Labi thurret nga Vlora

Hej Dibër, ja bane fora.

***Dan Cami, Preng Doçi,**

Adem Bojaxhiu


Adelina Gruda

Steblevë -Tiranë



Adelina Gruda me të shoqin Vath Gruda

FISI KORMAKU NË STEBLEVË



Nga **Shpëtim Kormaku**
Isak Kormaku

Stebleva daton qindra vjet përpara. Në defterin turk të regjistrimit të popullsisë së vilajetit të Dibrës, Stebleva njihet me emrin Stableva dhe ka patur 13 kryefamiljarë.

Fisi Kormaku është një ndër fiset e para të vendosura në Steblevë. Fisi Kormaku është vendosur në lagjen Soskamalle, afër kishës. Religjioni i tyre fillestar ka qenë të krishterë. Tokat e tyre shtrihen brenda edhe jashtë kufijve të sotëm të Republikës së Shqipërisë. Pas vitit 1990 kemi mësuar se familje me mbiemrin Kormaku ka edhe në Kroaci, Greqi, Rusi dhe Turqi. Egzistenca e kishës që në shekujt 14-15 tregon se influenca turke në krahinën dhe fshatin tonë ishte akoma e vogël në këtë periudhë. Xhamia në Soskamalle është ndërtuar më vonë.

Nga kujtimet tona kemi gjurmuar deri në 9 breza. Më i moçmi ndër kormakët, Meço Kormaku ka banuar në Llakaicë, Jabllanicë. Ai ka patur dy djem Ramën dhe Selimin. Rama pati një djalë Selmanin, ndërsa Selimi pati Demirin.

Selmani pati katër djem, ndërsa Demiri pati dy djem. Njëri nga djemtë e Meços, Selimi ka qenë rrobaqepës, terzi. Meshëtari i kishës së Steblevës Angelo Rajkovski kishte një djalë dhe donte ta bënte terzi (rrobaqepës) dhe e dërgoi atë çirak tek Selim Kormaku. Demir Kormaku humbi jetën dhe Nikolla, djali i Angelos kërkon të birësohet nga Selimi. U birësua, ndërroi fenë dhe u quajt Ismail. Më pas martohet me të venë e Demirit dhe lindin një djalë, Musanë.

Musai la si pasardhës Hamitin, Abdullain dhe Rustemin. Hamiti, djali i madh i Musait la Halitin, Abilin, Xhevahirin, Ademin, Beglien, Hajrien, Dhe Rabien, ndërsa Abdullai la Isufin, Sefedinin, Kadriun, Ahmetin, Pllumbin,

Nurien, Zanën dhe Bukuroshen. Rustemi nuk pati fëmijë.

Në vazhdim tërë pasardhësit e Selim Kormakut janë vendosur në Tiranë dhe në Elbasan. Në Tiranë është edhe dega e Malo Kormakut.

Dega e Ramë Kormakut dhe djalit të tij Selmanit. Selmani pati katër djem: Sulejmanin, Muratin, Meçon dhe Maliqin.

Sulejmani qëndroi në Llabunisht (Maqedoni). Meçoja pati 5 fëmijë, 2 djem dhe 3 vajza. Jusufi la katër fëmijë, ndërsa Sadiku la tre fëmijë. Murati la dy fëmijë,

Destani pati 9 fëmijë, katër djem dhe pesë vajza, Muratin, Isakun, Esatin, Enverin, Hatixhen, Ibrimen, Naferiden, Ndrçimin dhe Hydajetin.

Edhe këta kanë pasardhësit e tyre, Ermirin, Destanin, Gazmendin, Gencin, Ilirin, Artanin.

Osmani pati Hajdarin, Abdurrahmanin, Kadriun, Qerimenë, Dritën, Sanien. Vazhdojnë më tej me Nadiren, Bardhylin, Luanin, Elën, Ruzhdiun, Dritanin, Fatmirin, Elidën, Mimosën, Entelën.

E shoqja e Osmanit ishte nga fisi i Gjinajve.



Foto e vitit 1937

djalë, Shpëtimin si dhe dy vajza, Fatbardhën dhe Shkëndien. Shpëtimi ka një djalë Dorianin dhe dy vajza, Rebekën dhe Jonën.

Hasan Kormaku, djali i Maliqit, ishte një burrë i urtë, mjeshtër i punimit të drurit me shpirt artisti.

Punimet e tij nuk janë ruajtur. Një thesar etnografik, do të kishin qenë, po të ishin ruajtur. Ai pati 6 fëmijë, Selmanin, Faikun, Eminenë, Nafijen, Myrvetin dhe Fatimen.

Selmani pati tre fëmijë, Abibin, Sabrianin dhe Selvien. Faiku ka katër fëmijë, Fatmirën, Bardhylin, Gzimen dhe Mirën.

Kormakajt sot jetojnë në Tiranë dhe në Elbasan. Rreth

50 familje jetojnë në Itali, Greqi, Maqedoni, Kroaci, SHBA etj.

Pas kthimit nga Selaniku Sali Kormaku u vendos në Berat ku punoi për ndërtimin e urave. Vdiq dhe u varros me nderim në këtë qytet.

Gjatë Luftës së II Botërore në familjen e Destan Kormakut janë strehuar për dy vjet tre familje çifute. Këtë e dëshmon edhe Shoqata e hebrenjve që vepron në Shqipëri.

Kormakajt dallohen për punë, për shpirtin e tyre artistik. Janë gazmorë dhe të dashur, të dhënë pas tregëtisë, sportit dhe artit. Ata janë pjesa më e shëndoshë e traditës së fshatit dhe e zonës.



Foto e vitit 1938, pranë varrit të Baba Aliut

Saliun dhe Ramën. Rama nuk pati trashëgimtar, ndërsa Saliu la 5 fëmijë, Vahidin, Destanin, Osmanin, Idrizin dhe Zylfien (Xylka).

Saliu që mjeshtër ndërtimi. Për shumë vite ai që larguar në Selanik duke marrë me vehte dhe duke shkolluar edhe dy djemtë e tij Vahidin dhe Destanin.

Vahid Kormaku u bë mësues dhe intelektual i shquar i kohës. Ai ishte një patriot i vërtetë. Për të është shkruar gjërësisht. Ai ishte poliglott, biolog, historian dhe mësues i shquar. Ai përveçse në Steblevë dhe në Borovë punoi edhe në Gramsh.

Një shkollë mban emrin e tij: "Vahid Stebleva".

Vahidi la dy djem Ganiun dhe Tafilin. Tafili pati 5 vajza, Teutën, Afërditën, Lirinë, Lumturinë dhe Shpresën. Ganiu së bashku me të shoqen Demiren rritën 5 fëmijë, Vahidin, Besnikun, Bardhoshen, Hajrien dhe Violetën. Që të pestë të edukuar dhe të arsimuar me arsim të lartë, quadro të aftë dhe të devotshëm.

Destani u kthye në Shqipëri dhe hapi një restorant në Durrës. Punoi edhe në Kavajë. Në vitet 1924-1925 u vendos në Elbasan ku mori edhe vëllezërit e tij më të vegjël, Osmanin dhe Idrizin.

Idriz Kormaku u martua me Beglie Dishën dhe la një



Foto e vitit 1937

APEL I SHOQATËS "STEBLEVA"

Shoqata "STEBLEVA" vlerëson kontributin e banorëve vendas që punojnë aktualisht në fshat për ruajtjen e vlerave të gjithanshme të tij dhe njëkohësisht u bën apel atyre që të bashkëpunojnë me banorët e shpërngulur, për të bashkërenduar punimin e të gjithave tokave të fshatit, por kjo të bëhet me marrveshjen dhe mirëkuptimin e të dyja palëve. Në të kundërt kjo përbën shkelje të të drejtave të njeriut mbi pronën dhe shkelësit e ligjit duhet të përgjigjen.

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Redaksia e gazetës "Stebleva" fton të gjithë bashkëpunëtorët e shtypit, intelektualët dhe qytetarët e thjeshtë steblevas të kontribuojnë me bashkëpunimet e tyre për të pasqyruar bukurinë e natyrës së Steblevës, historinë e saj të lavdishme dhe njerëzit e saj të mrekullueshëm.

SHARRAT E STEBLEVËS, NJË PASURI E RRALLË KOMBËTARE

(Sipas rrëfimit të Emin Muratit)

Në vitin 1949 filloi shfrytëzimi privat i pyjeve tona. Bëmim dru zjarri dhe ja shisnim Ndërmarrjes së Prodhimeve të Ndryshme të Elbasanit.

Me 2 maj të vitit 1951 erdhi nga Elbasani shefi i industrisë së këtij rrethi Mehmet Dylgjeri dhe bisedoi në fshat me kryetarin e këshillit popullor Sadik Murati. U ra dakord që në vendin e quajtur Rrafshinë e Madhe (Golema Raven) të ngrihej një sharrë me motor naftë.

Bazamenti i stabilimentit u ngrit nga një minoritar me emrin Miço. Edhe teknik sharre ishte një monoritar tjetër me emrin Santo.

Ky stabiliment i vogël mori emrin Sharra e Steblevës.

Punëtorët e parë kanë qenë Dylbin Lila, Qamil Pirushi, Dylbin Çausi, Vath

Bushati, Kasem Fejza, Beshir Hoxha, Jakup Disha, Murat Murati, Dalip Murati, Selman Kormaku, Siljan Rajku, Martin Rajku, Rustem Kormaku, Ajdin Gruja, Shefqet Bajrami, Feim Agushi, Abil Ferhati, Ismail Llapa, Musa Ceta dhe Banush Cera nga Borova.

Përgjegjës dhe njëkohësisht magazinjer, furnitor isha unë, Emin Murati. Një herë në javë shkoja në Elbasan dhe merrja furnizimet me ushqime sipas racionit triskor, miell, vezë, mish etj.

Merrja edhe pjesë materiale këmbimi për sharrën si litar, sharra, lima etj.

Trupat tërhiqeshin me litar. Ishte punë shumë e rëndë.

Më vonë punën e magazinjerit ja dorzova Abil Ferhatit, i cili edhe ai ja dorzoi pas një farë kohe Ismail Llapës.

Në fillim të vitit 1953 sta-

bilimenti u dogj. U quajt punë armiqsore, megjithë sharra ishte konsumuar dhe i ishin mbaruar ditët.

Stabilimenti u ringrit i ri edhe më i organizuar dhe më i plotë, me administratë të plotë me drejtor ndërmarrje furnizimi punëtorësh ku përfshiheshin mencent, dyqanet, magazinat etj. Drejtor ka qenë Xhevat Lila, më vonë u bënë Aqif Musliu, Murat Uliu dhe Esat Gjini. Në seksionin e planit punonte Sali Hoxha, në seksionin e financës Demir Nura, Jonuz Hamza, Izet Gruja dhe Selim Avda.

U hap sektor i ri në Dragan me përgjegjës Ismail Lilën dhe normist Ibrahim Hoxhën. Në sektorin e Letmit drejtonte Xhevahir Caka. Në sektorin e Qendrës drejtonte Jonuz Gjini.

Në vitin 1955 krijohet ndër-

marrja e furnizimit të punëtorëve.

NFP është drejtuar për 15 vjet nga Abdurrahman Hoxha. Më pas kanë drejtuar Vesel Abazi, Iqmet Çausi dhe Iljaz Tamizi.

Nga viti 1956 deri në vitin 1987 kam punuar në sektorin e financës së NFP-së.

Magazinjerë kanë qenë Abil Kuburi, Bogdan Cfaruku, Vehap Kita (Letëm), Abdurrahman Moglica (Okshtun) Shahin Koçi (Prodan).

Në bar-bufenë e sharrave kanë punuar Esat Uliu, Xhavit Kuburi, Hysen Bajra, Adil Bale, Saraje Agushi dhe Ivan Cfaruku.

Në guzhinën e punëtorëve kanë punuar Bilal Uliu, Tafil Kormaku, Vahit Tamizi, Liman Nura, Xhemil Baraku, Selim Gruja, Selman Kuburi, Naxhije Llapa, Xhevdet Uliu, Naim Hoxha.

Në dyqanet e sharrave kanë punuar Shahin Kurti, Kadri Fejza, Hysen Uliu, Mehmet Hoxha. Ishin të punësuar edhe roje, barinj, mirëmbajtës etj.

Siç e theksova puna ishte shumë e rëndë. Dhjetra skoda ngarkoheshin me trupa për në Elbasan, prodhoni edhe dru zjari, shtylla miniere, lëndë të parë për eksport etj.

Në këtë stabiliment për shkak të punës së rëndë humbën jetën Murat Murati, Haxhi Kormaku dhe Ramiz Balla nga Borova.

Mbetën invalidë Xhevahir Disha, Xhevdet Uliu, Mehmet Nura, Bilal Lama, dhe Mehmet Hoxha.

Në këtë stabiliment çdo familje steblevase kishte nga një pjestar.

Pra menjë fjalë me sharrat ishte lidhur vetë jeta jonë.



Nga Ferit PIRUSHI

Siç e kam thënë edhe në një shkrim të mëparshëm të gazetës "STEBLEVA" dhe siç është theksuar edhe nga të gjithë shkrimet dhe kujtimet e bashkëfshatarëve të mi, fshati ynë i dashur Stebleva ka mbijetuar nëpërmjet luftërash dhe betejash, krizash ekonomike, epidemish sëmundjesh dhe një varfërie të tejskajshme.

Zanati i preferuar i steblevasve nuk ka qenë ustallëku, puna me gurin dhe drurin, por tregëtia. Steblevasit kanë qenë dhe janë edhe sot tregëtarë të sprovuar.

Gjyshërit e mi kanë punuar në Shkup dhe në Stamboll dhe janë marrë me tregëti ushqimore. Janë kthyer në Steblevë me para të kthyer në monedha floriri. Këto para i kanë përdorur për të ndërtuar shtëpitë dhe për të blerë toka, kullota dhe pyje.

Kështu kanë bërë edhe bashkëfshatarët e mi. Duhet theksuar fakti se kudo ku kanë punuar jashtë vendit steblevasit kanë ndihmuar njëri

tjetrin. Kjo ka bërë që ata të ecin përpara në punë dhe në jetë.

Pirush Disha aty rreth vitit 1895 me paratë e fituara në Shkup dhe Stamboll u vendos në Kavajë, ku bleu një shtëpi dhe sajoi një dyqan.

Pati shumë punë për vetë faktin e qënies afër portit detar dhe në rrugën "Egnatia". Ai ngriti një han në Gosë të Kavajës, ku mbante edhe shumë tufa më bagëti. Gjithashtu hapi dyqan edhe në Durrës dhe në Elbasan.

Gjatë luftës austro-hungareze meqenëse paraja austro-hungareze ishte shumë e fortë konvertoi shumë monedha floriri në kartë monedha austriake. Pas largimit të austrohungarezëve vlera e parasë ra.

Babai im Bexheti dhe Hasan Kormaku hapën një dyqan bulmetore në Tiranë. Prania e shumë tregëtarëve konkuroes bëri që të mos ecte ky lloj biznesi, kështu që e mbyllën.

Bexheti u largua për në Librazhd ku punonte si tregëtar me rrogë, ndërsa vëllai i tij Sefedini u kthye në Steblevë.

Shërbimin ushtarak e kreu në kohën e Zogut si rezervist në gazerat e Ali Rizait në Yzberisht të Tiranës. Aty shërbente si kryeguzhinjer. Kishte marrë si ndihmës bashkëfshatarin e

tij Ahmet Llapën. Ushtarët nga Stebleva dhe nga zona jonë i favorizonte me ushqim. Kaq kishte në dorë dhe e bënte. Në ushtri u njoh edhe me një profesor nga Dibra që i mësoi shkrim, këndim dhe arithmetikë. Ky kurs 6 muaj ishte gati sa shkolla fillore.

Bexheti ka patur shok fëmijërie Ibrahim Projkun. Ishte valltar i mirë dhe i binte bukur kavallit. Bexheti i binte çiftelisë dhe këndonte. Këndonin bashkë këngë shqipe nëpër dasma dhe kudo. Ibrahim dhe vëllai i tij Bajrami ishin një dyshe virtuozë. Në ushtri ka patur edhe dy shokë të ngushtë, byrazera nga Klenja, Mihal Maznikun dhe Muharrem Fergalin.

Pas ushtrisë kthehet në fshat.

Dan Ushini nga Klenja, që në atë kohë ishte qendër lokaliteti dhe udhëkryq i rëndësishëm, kishte ndërtuar një ndërtesë dykatëshe si hotel dhe si bufe-restorant për kalimtarët dhe nëpunësit. Kërkoj Bexhetin për të punuar në këtë lokal të rëndësishëm, duke e paguar me një rrogë të mirë.

Bexheti punoi shumë gjatë në Klenjë. Vinte vetëm në fund jave në shtëpi pasi kishte shumë punë.

Punoi për nandë vjet në Klenjë deri në mars të vitit 1939 kur na u dogj shtëpia në Steblevë dhe u detyrua të

kthehej.

Në Steblevë Vaid Kormaku kishte ndërtuar një hotel-restorant, ndërtim ky nga Selman Mersa. Meqenëse Vaidi nuk mund ta menaxhonte vetë sepse kishte obligime të tjera ja besoi atë Bexhetit që mori si ortak Bilal Uliun. Pati shumë punë sepse ishte një shoqëri italiane që ndërtonte dhe zgjeronte rrugën nacionale Librazhd-Dibër. Kishte edhe shumë reparte ushtarake të ushtrisë italiane të dislokuara në afërsi dhe që kryqëzoheshin nga Shkupi, Struga, Dibra e Madhe etj. Konsumohej shumë ushqim, pije alkolike etj. Bëhej xhiro e madhe.

Në mars të vitit 1943 italianët u tërhoqën nga Jugosllavia dhe nga këto terriore, kështu puna ra dhe dyqani u mbyll.

Bexheti si edhe shumë bashkëfshatarë të tij filluan punën me kuaj për transportim mallrash, shitje blerje, shitnim prodhimet tona dhe blinin materialet që na mungonin si kripë, vaj guri etj.

Ishte punë e rrezikshme. Quhej kontrabandë dhe mund të të konfiskohej malli nga autoritetet maqedonase.

Pas çlirimit Bexheti punoi 8 muaj në Zerqan si guzhinjer, por ishte shumë larg dhe e la. E kërkuan në konsumin e Shupenzës, ku punoi edhe aty rreth tetë

muaj.

Në vitin 1947 u vendos përfundimisht në Klenjë. Aty punoi për rreth 15 vjet derisa doli në pension.

Klenjasit e trajtonin Bexhetin si fshatarin e tyre. Ai rrinte në shtëpinë e Haziz Zunës. Kishte aty një dhomë të veçantë me shtresa ku përveç se flinte vetë, strehonte shumë herë edhe njerëzit e mbetur jashtë sidomos gjatë dimrit. U ndiste sobën, i ngrohete, i ushqente, pa interese, thjesht për njerzillëk.

Një natë rastisi që të mbetej në mes të rrugës Jashar Menzelxhiu.

I ishte prishur makina teksa udhëtonte për në Elbasan dhe më tej për në Bashkimin Sovjetik ku ndodhej për studime. U strehua tek Bexheti me gjithë dy fëmijët e tij. Shumë falenderime dhe urime nga ana e tij. Më vonë Jashari e ftoi për ta marrë në Peshkopi dhe për ti dhënë edhe strehim atje, por Bexheti nuk pranoi. As për në Elbasan për shtëpi e punë të mirë nuk pranoi. Por Jashar Menzelxhiu nuk e harroi kurrë. I çonte vazhdimisht të fala.

Destan Haxhia e pati marrë në fabrikën e fermentimit të duhanit por qëndroi vetëm 6 muaj dhe u kthye. Punoi edhe me ekspeditën gjeologjike në Klenjë për rreth 6 muaj. Por kurrë nuk largohet nga zona e Steblevës.

MBIJETESA

(Rrëfim për babanë dhe bashkëfshatarët e tjerë në periudhën 1914-1974)

HISTORI

SHQIPTARËT JANË AUTOKTONË SEPSE ZBRESIN DREJTPËRDREJT NGA ILIRËT



Nga Ramazan Hoxha *

Politikanët e sotëm të Maqedonisë hedhin vështirimin pas dhe kërkojnë nëpër monopetet e ngjarjeve historike për të gjetur gjurmë të një shtegu të mundshëm për një popullsi të "zgjedhur" drejt fatit dhe shkëlqimit të tyre kombëtar.

Ata e transferojnë historinë në histori kombëtare për të legjitimuar të qenurit e shtetit komb në ditët e sotme, duke rindërtuar të kaluarën e tyre të pretenduar. Linjat e prejardhjes kombëtare të pretenduar janë ndërtuar, përpunuar e tejzgatur në mënyrë që pasardhësit e një kombi tjetër të bëhen strehë për ligjërimin e grupit shumicë të sotëm, proces ky tipik i kombndërtimit të vjedhur, që shtrëmbëron vizionet historike për të kaluarën.

Idetë që ofrojnë të tilla histori janë tepër larg realiteteve historike dhe fizike, por ata bëjnë të qartë se identitetet kombëtare bashkëkohore shtrëmbërojnë vizionet tona për historinë. Sllavofolësit e Maqedonisë në të vërtetë kanë gjuhën e tyre vendase dhe dialektet, terminologjitë e lidhjes fisnore si dhe zakonet. Por refuzimi dhe mohimi i kësaj dalueshmërie, e cila përfaqëson "të tjerët", pra shqiptarët e kundododhur në Maqedoni dhe përhapja e panhelenizmit apo e pansllavizmit për këtë çështje janë karakteristikat themelore të ndërtimit të shteteve kombe në rajon. Këto zhvillime kanë qenë dhe janë thjesht mohime të identitetit kombëtar të shqiptarëve, të cilët përfaqësojnë grupet shoqërore më të mëdha autoktone në të tre Maqedonitë dhe përbëjnë lëndët bazë ngjizëse të këtyre formimeve.

Në historiografinë kombëtare greke, ashtu edhe në atë bullgare dhe sot maqedonase, të tilla zhvillime të kombformimit janë kategorizuar si "çlirim kombëtar" i popullit maqedonas, por siç e tregon historia, shqiptarët e këtyre hapësirave (në të tre Maqedonitë) kanë qenë dhe janë më

të shtypura pas vendosjes së sundimit grek, bullgar dhe maqedonas në vitin 1913 se sa kishin qenë nën sundimin osman.

Në këtë kuptim shumë studiues kombëtarë të këtyre shteteve kanë dëshmuar në jno-

Në këtë hulli po sjellim vetëm disa pasazhe në funksion të këtij argumenti. Në "Gjeografinë" e tij, Straboni, shkruan se popullsia e Epirit, Ilirisë dhe Maqedonisë flasin të njëjtën gjuhë, bile edhe flokët i presin të njëjtën mënyrë, kanë

George Fon Hahni në "Albaneische Studien" pohon: "Shqiptarët janë autoktonë sepse zbresin drejtpërdrejt nga ilirët, që ashtu si edhe popullsitë e Maqedonisë dhe Epirit rrjedhin të gjithë nga parahistorikët pellazgë

hjen e një të vërtete themelore të pranuar nga të gjithë se realiteti është i ndërtuar siç janë përfaqësitë tona kulturore të vehtes dhe të tjerëve ku identifikimi ndodh në shumë nivele, duke përfshirë fshatin, krahinën, komunitetin etj.

Ky lloj i ndërgjegjes amtare të këtyre niveleve i emërtuar nga studiuesit si "ndërgjegje tradicionale" është kontrast me të ashtuquajturën ndërgjegje kombëtare moderne, që egziston brenda një shteti-komb të ditëve të sotme.

Paradoksalisht, për një trashëgimi maqedonësh aleksandrinë grinden sot disa palë etnike dhe disa shtete që s'kanë të bëjnë aspak me të.

Të flitet për trashëgimi të Maqedonisë së lashtë nga sllavët apo sllavofolësit e atyre trevave është një absurd që nuk kërkon argumenta të tjerë, pasi mjafton fakti i mirënjohur historik se dyndjet nistore sllave datojnë rreth dhjetë shekuj mbas Aleksandrit dhe Perandorisë Maqedone të lashtësisë. Dhe, nëse realisht gjendet ndonjë gjurmë maqedone në grupet etnike sllavofolëse, kjo i dedikohet ose elementit autokton të sllavizuar në kohë të hershme, apo më vonë, ose ndikimit të institucioneve politike.

E njëjta gjë mund të thuhet për bullgarët që në të vërtetë janë fise avare të sllavizuar, që janë përzier me mbetjet e popullsisë autoktone thrako-ilire.

Ndërsa për grekët pavarësisht manipulimit të madh që është bërë në historiografi, argumentet mbetën përsëri të vobegte.

Autorët e lashtësisë, qoftë edhe autorët modernë në të gjitha format e shprehura të çojnë në të vetmin përfundim: raca e vetme që mund të pretendojë në mënyrë të përligjur trashëgimi maqedone dhe Aleksandrin e Madh janë pasardhësit e asaj popullsie, që mbizotërojnë gadishullin ilirik (Ballkanik), pra shqiptarët.

të njëjtat zakone dhe qeverisen nga kuvendi i pleqve, të cilin e quajnë "Plakonia".

Nga Justin i mësojmë se maqedonasit ishin një racë pellazgjike. Ndërsa tek Kuin Kyrsi dhe Plutarku shohim se midis greqishtes dhe maqedonishtes egziston një ndryshim i thellë saqë duke kuptuar njëri prej dy gjuhëve nuk mund të kuptojnë edhe gjuhën tjetër.

Trog Pomper shpreh: "Albanët (Arbërit), një pjesë e të cilëve sot kanë zënë vend në Peloponez, një pjesë në Maqedoni, Iliri dhe Epir."

Puarso dhe Kaiks thonë: "Mbretëria e Maqedonisë ja dedikon origjinën e saj një kolonie pellazgjike të dëbuar nga Histiokatilda prej kadmenëve rreth vitit 1302 para erës së re. Ata u vendosën në Pind nën emrin maqedonas dhe u shtrinë deri në Emathia.

Po ashtu George Fon Hahni në "Albaneische Studien" pohon: "Shqiptarët janë autok-

dhe këtyre me pellazgët e lashtë."

Biondeli pranon se origjina e shqiptarëve është pellazgjike dhe padyshim janë të një gjaku me maqedonasit e lashtë, thrakët, dakët dhe ilirët.

Ndërsa për dallimin midis grekëve dhe maqedonasve të kohës së Aleksandrit, Vajgali vëren "Për botëkuptimin grek ishte diçka e vetëkuptueshme që një njeri të ishte edhe përendi. Por për maqedonasit ky mendim ishte po aq i huaj sa ç'është për ne sot, duke dalluar një sistem thelbësor në sistemin konceptual të grekëve dhe popullsisë të tjera rrënjëse si maqedonasit, ilirët, epirotët, që kishin të njëjtën rrënjë pellazgjike.

Në "Quaranta secolli" E. Bidera shkruan: "... Qytetërimi pellazg nuk u ndal veçse në Epir, as nuk humbi siç besohet. Është ky popull fisnik, që për tu kujtuar qëndroi ende me gjuhë të tij tepër të lashtë në Shqipëri, Thesali, Maqedoni, në pjesën më të madhe të Dalmaçisë, të Serbisë etj.

Prof. M. Markiano shpreh: "Populli shqiptar është, nëse jo pellazgjik, me origjinë pellazgjike, ose një familje e asaj rrace shumë të lashtë që populloi brigjet e Azisë së Vogël, Greqinë, Thrakinë, Maqedoninë, Epirin, Mizin dhe Dakinë."

Evokimi i trashëgimisë maqedone të lashtësisë dhe i figurës qendrore të saj, Aleksandrit të madh, në mënyrë organike zë një vend kryesor edhe në trajtimin intelektual të kohës së ngjizjes së ndërgjegjes kombëtare shqiptare, Rilindjes, ku nuk vërehet asnjë sforcim apo manipulim propogandistik në

E. Mashi në Annales des Voyages shpreh: "Është e drejtë të besohet se gjuha moderne e shqiptarëve është ajo që flisnin në lashtësi maqedonët, ilirët dhe epirotët."

afirmimin e këtij elementi si shqiptar.

Kështu ideologu i shqiptarizmit Pashko Vaso shkruan: "Na shqiptarët kemi qëndruar tash tremijë vjet e ma tepër, e kemi mbajtur gjuhën e mendimin, karakterin e trimërinë, dashurinë e lirinë që na kanë lënë të parët, njata pellazgë që i përmendën e i ngulën mbretit e Epirit, Maqedonisë dhe Ilirisë."

Sipas pohimeve të të gjithë historianëve e folura maqedone ndryshonte nga të gjitha idiomat që përdorshin në Greqi. Nga kjo del se për t'u folur të vetëve, (maqedonasve),

Aleksandri nuk mund të përdorte gjuhë greke. Pra gjuha që dinin dhe që flisnin ushtarët e Aleksandrit dhe Filipit nuk mund të ishte veçse gjuha e pellazgëve të lashtë, ajo që flitej në Epir e që flitet sot e kësaj dite kudo në Shqipëri.

Dora D'istria shpreh: "Ata pellazgë që mitet helenike i bëjnë të lindur" përpara hënës", këta bij të pellazgut, zonja Dora që ka mbledhur me kujdes dhe ka diskutuar me kaq mprehtësi traditat popullore të bashkëatdhetarëve të saj, rivendikon për racën shqiptare këto origjina të ndritura dhe nderin që ka nxjerrë Filipin, Aleksandrin e Madh, Aristotelin, Pirron, mbretëreshën Teuta."

Ndërsa Jeronim De Rada mbron tezën se popullsia parahelenike e Greqisë së sotme, ashtu si edhe maqedonasit e Aleksandrit, ishte e njëjtë me atë të shqiptarëve të sotëm.

Po ashtu rektori i Kolegjit të Palermos Nikollë Keta shënon: "Origjina shqiptare rrjedh nga maqedonasit e lashtësisë dhe janë të njëjtë me ta, se gjuha është një nga më të vjetrat në botë dhe se Shqipëria në kohë të lashta ka qenë ajo pjesë e Maqedonisë që shtrihet prej Drinit të Bardhë, Epirit dhe një pjesë të Peloponezitet dhe që quhej Alvanitia prej shkruarëve bizantinë.

Madhështia e Maqedonisë dhe e Aleksandrit të Madh janë një lëndë tepër e turbullt dhe pa shtrat në vetëdijen e sllavëve dhe të grekëve. Ata ngatërojnë kohët historike dhe përziejnë elementin ballkanik rrënjës me atë të ardhur në kohë më të vona. E gjithë përpjekja shekullore greke për të helenizuar totalisht një popullsi e një territor të fituar nga pazarllëqet e rrethana historike dhe jo nga një e drejtë kombëtare vihet në dyshim. Edhe pas një procesi të ethshëm shtetëror tjetërsimi mbi ato vende gjen gjurmët dhe rrënjët e identiteteve etnike të ndryshme.

Në Maqedoninë e sotme gjen elementë etnikë që e turbullojnë debatin mes palëve. Atje gjen grekë sllavofolës, sllavë grekofolës, grekë turkofolës, shqiptarë grekofolës si dhe shqiptarë sllavofolës. Me përjashtim të shqiptarëve të gjithë grupet e tjera etnike krijojnë një mishmash kujtesor për trashëgiminë e tyre. Tek ata Aleksandri i madh dhe Maqedonia e lashtë nuk thonë asgjë. Në të kundërt, në vetëdijen popullore ndër shqiptarët, koncepti është mjaft i pastër dhe shëmbëlltyra e Lekës së Madh vjen në një vision të qartë dhe të pandotur me elementë të tjerë absurdë.

Ai vjen natyrshëm si një evokim i brëndshëm shpirtëror e vetëdijësor dhe pa ndikime arsimore apo propogandistike.


Reportazh

COPEZA BISEDASH DHE NDODHI TË PATHËNA MË PARË, PËR BASHKËFSHATARËT E MI

Nga Velo CFARKU

**1. "E gjeta zoti mësues!"
"E gjete ti apo shpulla ime?"
(Rrëfim për mësuesin e
nderuar Vahid Kormaku)**

Me 4 maj 2006 takohem me bashkëfshatarin dhe bashkëmohatarin tim Met Hoxha. Pimë nga një kafe në klubin e Vahid Kormakut. Biseda erdhi natyrshëm nga një shkrim në



gazetën "Stebleva". Profesor gjerman Fridrih Margraff e ka njohur personalisht Vahid Kormakun dhe ka bashkëpunuar me të për florën dhe faunën e Shqipërisë.

Edhe unë e kam patur mësues Vahidin, më thotë Meti.

-Çfarë mban mend ndonjë episod nga mësues Vahidi ? e pyes

-Kanë kaluar vite, 65 vjet më parë. Më çoi në dërrasë të zezë dhe më tha: "Shkruaj numrat deri në 100!". Unë vazhdoja deri në numrin 88. Pastaj kapërceva tek 90. Pra harrova numrin 89. M'u fiksua ashtu gabim.

-Edhe një herë, më tha, numëro deri në 100!"

-Përsëri unë harrova numrin 89 dhe kalova tek numri 90.

Mësues Vahidi më qëlloi me një shpullë. Në moment m'u kujtua numri 89.

-E gjeta, i thashë.

-E gjete ë ?

-Po, i thashë e gjeta.

-E gjete kjo, shpulla ime.

Kjo është historia ime e paharruar me mësues Vahid Kormakun. Ishte një mësues autoritar dhe kompetent në zanatin e mësuesisë. Nuk të falte kur vinte puna për të mësuar, për të nxënë mësimin që të jepte.

Ndërkohë seç mu kujtua një detaj nga poema pedagogjike e Makarenkos se

ndëshkimi është pjesë e edukimit.

2. Kryepleqtë e Steblevës ndër vite

Siç është thënë dhe është shkruar Stebleva përbën një rast unik për tapinë e saj që nga koha e Turqisë. Kjo tapi është djegur, kur është djegur shtëpia e Mustafa Demirit në vitin 1920. Por në vitin 1937 tapia e Steblevës ripërtërihet dhe regjistrohet në hipotekën shtetërore të kohës së Zogut nga kryeplaku i atëhershëm Adem Bojaxhiu.

Stebleva ka zënë dhe zë një vend me peshë në tërë krahinën e Dibrës. Këtë e ka arritur në saj të burrave të mençur që ka patur. Burra me autoritet kanë drejtuar ndër vite duke bërë të mundur mbarëvajtjen e punëve të fshatit.

Qefalinjtë e parë të kohës së Turqisë kanë qenë Liman Bojaxhiu, Sekulla Çota, Vangjel Cfaruku.

Kryeplaku më jetëgjatë, që nga koha e Zogut deri në vitin 1944 ka qenë Adem Bojaxhiu.



Kur e ka dorëzuar detyrën në vitin 1944 ka rekomanduar Hamit Abazin që e mbajti deri në vitin 1945. Pas Hamitit për një kohë të pakët ka qenë Kadri Tamizi. Në vitin 1946 kryetar këshilli ka qenë Petro Zorba dhe sekretar këshilli Vahid Tamizi. Hasan Avda ka qenë për pak kohë. Sadik Murati ka qenë për 16 vjet, 4 mandate. Jakup Projku ka qenë për 5 mandate, me sekretar Jonuz Hamza. Më pas kanë qenë Isak Kurti, Habib Kormaku, Sefer Gruja, Vera Pirushi (Hasani), Fehim Kita, Dilaver Abazi, Ismail Tamizi, Ferit Tamizi, Enver Gruja, Esat Gjini, Sabian Murati,

Kryeplaku aktual është Rexhep Kurti. Kryepleqtë më jetëgjatë në krye të detyrës kanë qenë Adem Bojaxhiu,



Sadik Murati dhe Jakup Projku.

Në bisedë me Iljaz Tamizin flasim për sharrat e Steblevës. Jo rastësisht në vitin 1951 u fillua puna në sharrat e Steblevës që e mbajtën gjallë këtë fshat dhe tërë zonën për 40 vjet.

Kujtojmë punonjësin e parë të këtyre sharrave Petro Zorbën si dhe dhjetra punëtorë e kuadro nga Stebleva dhe fshatrat për rreth. Flasim edhe për hidrocentralin e parë që u ndërtua në vitet 1956-1957 tek shtëpia e Martin Rajkut, që u sajua me fuçi të salduara dhe që për të kontriboi shumë Abdurrahman Hoxha. Një hidrocentral të vogël me një vijë uji sa për dy shtëpi bëri edhe Ismail Llapa që i dha dritë edhe familjes së Bogdan Cfarikut.

3 ... I dalin për zot pasurive të tyre natyrore

Stebleva gjithmonë ka pasur zërin e saj vendimarrës në tërë zhvillimet ekonomiko-shoqërore të krahinës dhe më gjërë. Steblevasit janë shquar për patriotizëm edhe burrëri, shquhen edhe sot si punëtorë të talentuar, bujq e blegtorë të palodhur, tregëtarë të zotë dhe me zë deri në Ballkan.

Këto veti dhe vrytje janë trashëguar ndër vite deri në

ditët e sotme. Ne sot me të drejtë duhet të jemi krenarë si pasardhës të atyre brezave që kanë luftuar e punuar për trojet e tyre, për mbijetesën aq të mundimshme në kushtet e varfërisë së tejskajshme, por kurdoherë kryelartë, të ndershëm, me moral e karakter të fortë, në beslidhje dhe solidaritet. A nuk të bëjnë krenarë aktet e guximshme të burrave të shquar steblevas, që në kohë

tur pasurinë pyjore dhe ujore nga grabitës gjithëfarësh ?

Pas vitit 2005 steblevasit u bashkuan dhe u thanë ndal hajdutëve ordinerë që vinin nga shumë drejtime për të grabitur pyjet tona.

Tani po u thonë përsëri ndal grabitësve të ujit të Raduçit, nëpërmjet dokumentesh, lejesh dhe tenderash të dyshimta.

Shoqata "STEBLEVA" e



të Turqisë për të mbrojtur trojet dhe pasuritë e tyre kanë shquar dhe kanë hapur gjyqë deri në Carisgrad dhe kanë fituar ? A nuk të bëjnë krenarë edhe sot në kushtet e demokracisë aktet e guximshme të burrave kurajozë, steblevasve të sotëm, që u ngritën në këmbë me vendosmëri për të mbrojt-

bashkuar si kurrë ndonjëherë po mbron trojet e saj, tokat, pyjet, kullotat, burimet ujore etj.

Në ndihmë të steblevasve me veprime energjike në përputhje me ligjet e shtetit janë vënë edhe banorët e Klenjës dhe të Gjinovecit, të cilët e kanë shpresën për jetë tek ky burim uji.